

SHQIPËRIA I BASHKOHET KOMITETIT NDERKOMBËTAR TË ELEKTROTEKNIKËS (IEC)

Gjenevë, në 24 Prill 2009, Këshilli i IEC miratoi aplikimin e Republikës së Shqipërisë si anëtarin e 76^{të} të saj. Ky Komitet numëron në familjen e tij 76 anëtarë dhe 83 Afiliate nga vendet në zhvillim – ose përfaqësim i 95 % të popullsisë në nivel botëror.

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), i është bashkuar IEC si Anëtar i Asociuar me të drejtë vote të kufizuar (vetëm në fushat që mbulojnë 4 Komitete Teknike të IEC). DPS më parë ka kaluar me sukses dhe ka zbatuar me korrektësi rregullat dhe statutin e IEC në statusin e Pjesëmarrësit në Programin e Vendeve Afiliate të IEC – status, i cili i mundësonte DPS akses vetëm për 200 standarde në vit në fushën e elektroteknikës dhe ku DPS nuk kishte të drejtë vote për asnjë standard që përgatitej dhe publikohej nga IEC.



Miratimi i aplikimit të Shqipërisë si anëtar i Asociuar i IEC, ndër të tjera, siguron që DPS të ketë akses të plotë për të marrë dhe adoptuar të gjitha standardet që publikon e miraton IEC. Pra, me pak fjalë, ekonomia Shqiptare tani mund t'i gjejë standardet ndërkombëtare të fushës së elektroteknikës si Standarde Shqiptare (S SH) me çmime shumë herë më të ulëta se tregu ndërkombëtar.

Arritjet e Republikës së Shqipërisë në prodhimin e energjisë dhe investimet e bëra në fushën e telefonisë, tregojnë se ekonomia Shqiptare kërkon dhe do të kërkojë më shumë në të ardhmen e afërt të punojë sipas standardeve dhe teknologjisë më të përparuar në nivel ndërkombëtar në këtë fushë.

Shqipëria aktualisht është Anëtare pa të drejtë vote në Organizmat Europiane e ndërkombëtare të Standardizimit (CEN & CENELEC dhe ISO) dhe po punon për plotësimin e objektivave të vëna edhe në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) për t'u bërë anëtarësuar në këto organizma me të drejta të plota, që do të thotë se Shqipëria, e përfaqësuar nga DPS, të ketë të drejtën për të mbrojtur interesat kombëtare në fushat që mbulohen nga organizma.

Për më tepër informacion na kontaktoni:

Tel.: + 355 (04) 222 62 55 / 223 48 54

Fax.: + 355 (04) 224 71 77

E-mail: info@dps.gov.al

Web: www.dps.gov.al

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit

Adresa: "Mine Peza", 143/3

1014 Tiranë - Shqipëri